



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

**UDHËZUESI PËR APLIKANTËT E GRANTEVE
MZHR/2022**

**Skema e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar“ PZHRB 2022
Start-up dhe Biznes ekzistues Lot I dhe Lot II**

Autoriteti kontraktues:

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR)

**Afati për dorëzimin e aplikacionit:
Nga 14 Mars 2022 deri më 13 Prill 2022 ora 16:00**

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| 1. SKEMA E GRANTEVE „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar” | 3 |
| 1.1. Hyrje..... | 3 |
| 1.4. Përkrahja financiare e ofruar nga autoriteti kontraktues (MZHR) | 4 |
| 2. RREGULLAT PËR THIRRJEN PËR PROPOZIME | 5 |
| 2.1 Kualifikimi i aplikantëve: kush mund të aplikojë? | 6 |
| 2.2 Aplikantët që nuk kualifikohen..... | 6 |
| 2.3 Veprimet e kualifikueshme: veprimet për të cilat mund të parashtrohet aplikimi..... | 6 |
| 2.4 Sektorët apo temat | 7 |
| 2.5 Lokacioni | 7 |
| 2.6 Llojet e veprimit/projektit | 7 |
| 2.7 Kualifikueshmëria e shpenzimeve: kostot që mund të merren parasysh për grantin; | 8 |
| 2.8 PROCEDURAT E PROKURIMIT | 9 |
| 3. SI TË APLIKOHET DHE PROCEDURAT QË DUHEN NDJEKUR | 9 |
| 3.1 Mënyra e aplikimit | 9 |
| 3.2 Ku dhe si të bëhet aplikimi | 11 |
| 3.3 Afati i fundit për aplikim..... | 12 |
| 3.4 Informata të mëtutjeshme për aplikimin..... | 12 |
| 4. Kriteret e Vlerësimit | 12 |
| 5. ANKESAT | 12 |

1. SKEMA E GRANTEVE „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“

1.1. Hyrje

Kosova është në një fazë të hershme dhe ka shënuar progres në zhvillimin e një ekonomie funksionale të tregut. Rritja ekonomike ishte e fuqishme, por situata shumë e vështirë e tregut të punës mbetet shqetësuese.

Papunësia vazhdimisht e lartë e të rinjve tregon për një mungesë të përafritit mes rezultateve të arsimit dhe nevojave të tregut të punës. Largimi i kuadrove, sidomos e të rinjve të arsimuar, përbën gjithashtu një sfidë ekonomike afatmesme/afatgjatë. Politikat aktive të tregut të punës, skemat e para-kualifikimit dhe programet e arsimit profesional mbeten të papërshtatshme.

Ministria e Zhvillimit Rajonal, bazuar në mandatin ligjor që ka, çdo vit implementon programe për zhvillim rajonal të balancuar, Programe këto që kanë impakt të drejtpërdrejt në zhvillimin e bizneseve mikro dhe të vogla, zgjerimin e kapaciteteve të tyre prodhuese apo shërbyese, si dhe në gjenerimin e vendeve të reja të punës, andaj edhe këtë vit MZHR lanson Thirrjen “Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar” (PZHRB 2022), me qëllim të përkrahjes së start up-ve dhe bizneseve ekzistuese, rrjedhimisht MZHR duke u mbështetur në mandatin e saj zhvillon dhe menaxhon këto programe për të ofruar zhvillim socio - ekonomik të balancuar në Rajonet Zhvillimore të Kosovës, si dhe bënë promovimin e tyre.

MZHR me lansimin e grant skemës për financimin e sektorit privat ndihmon bizneset që të plotësojnë nevojat e tyre për të bërë biznes si dhe zgjerimin e kapaciteteve të tyre prodhuese e shërbyese pas pranimit të përkrahjes si dhe rritjen e qarkullimit dhe zvogëlimin e importit si dhe nxitjen e eksportit.

MZHR përmes këti Programi në koordinim me partnerët ndërkombëtar ka arrit të ndihmojë bizneset të zgjerojnë kapacitetet e tyre prodhuese duke arritur një qëndrueshmëri afatgjatë të funksionimit të bizneseve. Janë realizuar trajnime për ngritjen e kapaciteteve të qëndrueshmërisë së bizneseve ekzistuese, në veçanti është punuar me Start- upe në funksion të zhvillimit dhe përkrahjes së tyre si biznese fillestare.

MZHR mbanë sesione informuese për aplikantët potencial / bizneset sa i përket aplikimit online në sistemin elektronik eKosova si dhe sesione informuese për implementim të projekteve. Këto sesione organizohen vazhdimisht në koordinim me AZHR-të në Rajonet Zhvillimore me të cilat operon MZHR .

Gjithashtu kjo skemë inkurajon aplikime me projekte inovative nga gratë dhe të rinjtë sikur që ju bënë thirrje komuniteteve jo shumicë të aplikojnë në kuadër të kësaj skeme.

Në këtë kontekst, gjithashtu MZHR ka rrit përkushtimin rreth krijimit të mundësive të reja me donatorë vendor dhe ndërkombëtar, te ngritjes së kapaciteteve për aplikim dhe implementim të projekteve në bashkëpunim me partnerët: BERZH, UNICEF, GIZ, USAID, CARITAS, etj.

Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes kësaj Skeme mbetet e përkushtuar të mbështesë edhe më fuqishëm projektet e qëndrueshme të udhëhequra nga gratë, te fuqizoj gratë në të bërit biznes si dhe të rrisë kapacitet e tyre profesionale, menaxheriale për një qëndrueshmëri afatgjatë të biznesit.

Ministria e Zhvillimit Rajonal në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar ka mbështetur dhe vazhdon të mbështes prodhimin dhe shërbimet nga segmenti i prodhimit, ku veçohen produktet nga plastika, druri, lëkura, prodhimi i ushqimit, pijeve etj, ndërsa në kuadër të veprimtarisë së shërbimeve janë financuar shërbimet si: gastronomia, marketingu digjital, mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve, shërbime filmike dhe të produksionit, riparim të pajisjeve elektrike, shërbime gjeodezike, inxhinjerisë, arkitektures, shërbime të parukerisë, shërbime të programimit (softwer), etj.

Në vijim, janë të përshkruara të gjitha kriteret e aplikimit dhe udhëzimet për aplikantët potencial.

Grant/skema „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“

MZHR me lansimin e grant skemes për financimin e sektorit privat ju ndihmon atyre që të plotësojnë nevojat e tyre e të bërit biznes.

Synimi kryesor i skemës së granteve për sektorin privat është të mundësojë që projektet cilësore afariste të implementohen e zhvillohen ma tej në rritjen e kapaciteteve të tyre në të gjitha segmentet duke përfshirë edhe krijimin e vende të reja të punës të cilat do të gjenerohen nga rritja e ndërmarrjeve ekzistuese që janë të alokuara në sektorët që kanë potencial më të madhë për rritje. Në disa raste fokusi do të jetë në nënsektorë në kuadër të sektorit ekzistues.

Ofrimi i ndihmës përmes grantit të lansuar nga ana e MZHR-së për ndërmarrjet në rritje dhe ato fillestare në këta sektorët do të ketë ndikim pozitivë në krijimin e vendeve të reja të punës.

1.3. Synimet e Thirrjes për Propozime

Synimi i përgjithshëm i kësaj Thirrje për Propozime është zhvillimi socio-ekonomik rajonal i balancuar përmes zhvillimit të ndërmarrësisë në Rajonet zhvillimore të Kosovës.

Synimet specifike të kësaj Thirrje për Propozime janë:

- i. Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për të rinjtë;
- ii. Përkrahja e zhvillimit të bizneseve të reja dhe atyre me potencial rritjeje;
- iii. Përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve.

1.4. Përkrahja financiare e ofruar nga autoriteti kontraktues (MZHR)

Shuma e përafërt e kësaj thirrje është rreth 1,373.000.00€ (një milion e treqind e shtatdhjet e tremijë euro). Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Ministria e Zhvillimit rajonal shumë prej rreth 1,373.000.00€ (një milion e treqind e shtatdhjet e tremijë euro) do ta ndaj për të tri kategoritë/Lot-et në mënyrë të balancuar për Rajonet Zhvillimore.

- a) Në kategoritë Start-up dhe Lot 1 Biznes ekzistues kanë të drejtë aplikimi sektoret dhe veprimtarit pa përjashtim, kurse
- b) Në kategorinë Lot 2 Biznes ekzistues të drejtë aplikimi kanë vetëm bizneset që segment të veçant kanë prodhimin.

Grantet do të ndahet në tri Lote, si vijon:

Loti 1¹ – Start-up;

Loti 1² – Biznese ekzistuese - Ndërmarrjet mikro dhe të vogla (me një qarkullim prej 2,000.00€ deri në 10,000.00€ nga viti i fundit kalendarik të dëshmuara nga ATK);

Loti 2 – Biznese ekzistuese - Ndërmarrjet mikro dhe të vogla (me një qarkullim prej 10,000.01€ deri në 300,000.00€ nga viti i fundit kalendarik të dëshmuara nga ATK);

Sqarim: Sipas kategorizimit të ATK-së dhe sipas Ligjit Nr. 04/L-220 për Investime të Huaja, ndërmarrjet mikro dhe të vogla kategorizohen:

1. Ndërmarrjet mikro prej 0-9 punëtor;
2. Ndërmarrjet e vogla prej 10-49 punëtor.

Qarkullimi duhet të paraqitet me rastin e aplikimit për grant në platformën [eKosova](#), përmes dëshmisë për Qarkullimin vjetor të dëshmuar nga (ATK) për vitin 2021;

1.5 Shumat e granteve

Çdo grant i kërkuar sipas kësaj Thirrje për Propozime duhet të jetë brenda Shumave vijuese minimale dhe maksimale:

Loti 1 – Start-up

Nga 2,000.00 € deri në 5,000.00 €;

Loti 1 Biznese ekzistuese - Ndërmarrjet mikro dhe të vogla

Nga 5,000.01 € deri në 10,000.00 €;

Loti 2 Biznese ekzistuese – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla

Nga nga 10,000.01 – 20,000.00€;

Secili grant i kërkuar sipas kësaj Thirrje për Propozime duhet të jetë brenda **përqindjeve minimale dhe maksimale të kostos totale të kualifikueshme** për veprim:

Për të gjitha Lot-et, përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët duhet të jetë nga 10% deri në 40%. Shuma që kërkohet nga Autoriteti Kontraktues nuk mund të jetë nën 60% e kostos totale të projekt propozimit. Nëse gjatë realizimit të blerjeve, përfituesi ka arritë ta implementojë projektin më çmime më të vogla se ato të planifikuara atëherë mund të zbritet bashkëfinancimi deri në vlerën minimale të lejuar, por nëse projekti është implementuar edhe nën vlerën e bashkëfinancimit minimal atëherë zbritet edhe shuma e financimit të MZHR-së në mënyrë proporcionale për tu siguruar që projekti bashkëfinancohet nga përfituesi me vlerën minimale prej 10%.

2. RREGULLAT PËR THIRRJEN PËR PROPOZIME

Këto udhëzime përcaktojnë rregullat për dorëzimin, përzgjedhjen dhe implementimin e projekteve (veprimeve) të financuara sipas kësaj Thirrjeje për Propozime. Ekzistojnë tri tërësi të kritereve për kualifikim, që kanë të bëjnë me:

- Aplikanti (ët) që mund të kërkojnë grant;
- Veprimet (lloji i projektit të biznesit) për të cilin mund të jepet granti;

¹ Ky Lot i dedikohet ideve të biznesit për Startup të cilat nuk janë ende të regjistruara si biznese.

² Ky i dedikohet ndërmarrjeve ekzistuese mikro dhe të vogla të cilat kanë realizuar qarkullim vjetor për vitin e fundit fiskal prej 2,000.00 deri në 10,000.00 €, nëse qarkullimi është nën apo mbi këtë vlera atëherë nuk ka drejtë të aplikojë për këtë skemë (Lot 1) Biznes ekzistues.

- Lloji i kostos që mund të merret në përcaktimin e shumës së grantit.

2.1 Kualifikimi i aplikantëve: kush mund të aplikojë?

Për t'u kualifikuar për grant, aplikantët duhet:

- Të jenë shtetas të Kosovës.
- Të jetë ndërmarrje në pronësi 100% private, të regjistruar në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës.³
- Të jetë në gjendje të demonstrojë likuiditetin e kompanisë (apo likuiditetin potencial);
- Të jetë i regjistruar për aktivitetet e parapara me veprimin e propozuar në kohën e pranimit të grantit (Start-up);
- Bizneset ekzistuese që aplikojnë për kategoritë Lot 2 Projekt Propozimi i tyre duhet të ketë synim ekskluziv prodhimin.
- Të mund të demonstrojë që të gjitha kontributet dhe tatimet janë përmbushur⁴;
- Të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e veprimeve.

2.2 Aplikantët që nuk kualifikohen

Aplikantë potencialë nuk mund të marrin pjesë në Thirrje për propozime apo të përfitojnë grante nëse gjenden në ndonjërin prej situatave që renditen si më poshtë:

- Kanë bankrotuar apo janë në mbyllje, janë nën administrim të gjykatave, kanë hyrë në marrëveshje me kreditorë, kanë pezulluar aktivitetet afariste, i janë nënshtruar procedurave në lidhje me këto çështje, ose janë në situata analoge që lindin nga procedurat e përcaktuara me legjislacion apo rregullore vendore;
- Ata, apo personat që kanë autorizim përfaqësimi, vendim-marrjeje apo kontrolli mbi ta, janë dënuar për një vepër që ka të bëjë me sjelljen profesionale me aktgjykim të një autoriteti kompetent (pra kur nuk ka mundësi apelimi);
- Nuk janë në përputhje me obligimet e tyre sa i përket pagesës së kontributeve apo pagesës së tatimeve në pajtim me dispozitat ligjore të vendit në të cilin janë themeluar;
- Ata, apo personat që kanë autorizim përfaqësimi, vendim-marrjeje apo kontrolli mbi ta, kanë qenë subjekt i një aktgjykimi të prerë e të plotfuqishëm për mashtrim, korrupsion, përfshirje në organizatë kriminale, shpëlarje të parave apo ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm, ku aktiviteti i tillë i paligjshëm është dëmtues për interesat financiare të Kosovës;

2.3 Veprimet e kualifikueshme: veprimet për të cilat mund të parashtrahet aplikimi

Definicioni:

Veprimi (apo projekti) përbëhet nga një tërësi aktivitatesh.

Kohëzgjatja:

Kohëzgjatja e planifikuar e projektit që financohet nga MZHR nuk mund të tejkalojë 6 muaj (përveq nëse ndryshe parashihet me kushtet e kontratës).

³ Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha fletët/informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, certifikata duhet të jetë e re lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues;

⁴ Vërtetimi tatimor me validitet në ditën e aplikimit; me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK (mund të nxjerret online nga uebfaqja e ATK-së);

2.4 Sektorët apo temat

Ndërmarrjet që operojnë në prodhimin dhe përpunimin e produkteve, si dhe në shërbimet komerciale janë të kualifikuara të aplikojnë.

Megjithatë ju lutemi ti referoheni dhe ti përmbaheni në mënyrë strikte pikës 1.4 të këtij Udhëzuesi në veçanti pikave a) dhe b).

Interes i veçantë i kushtohet projekteve që kanë mundësi të zëvendësojnë importet, dhe të krijojnë eksporte që mbulojnë nevojat dhe prioritetet e mjedisit lokal.

- Tregtia (me pakicë e shumicë), ndërtimtaria, bujqësia (çdo pajisje apo aktivitet që ndërlidhet me fushveprintarinë e bujqësisë që financohet nga MBPZHR përjashtimisht pajisjet/makineritë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve) dhe shëndetësia janë sektorë që NUK KUALIFIKOHEN.

2.5 Lokacioni

Veprimet duhet të ndërmerren në Republikën e Kosovës.

2.6 Llojet e veprimit/projektit

Propozimet për financim duhet të jenë të pavarura teknikisht dhe financiarisht. Veprimet duhet të kenë ndikim të prekshëm dhe të dukshëm tek kompanitë dhe rritjen e punësimit, rritjen e kapaciteteve prodhuese, përmirësim apo optimizim të cikleve jetësore të zhvillimit të produkteve/shërbimeve dhe diversifikimin e produkteve/shërbimeve, kanale të reja të shpërndarjes dhe shitjes në Kosovë apo tregje ndërkombëtare, zhvillimin e zinxhirit të vlerave dhe të ngjashme.

Llojet vijuese të aktiviteteve në përputhje me synimet e Programit llogariten si shpenzime të kualifikueshme, dhe mund të financohen sipas kësaj Thirrjeje për Propozime:

- Investimet në asete të prekshme që kanë të bëjnë ose me blerjen e pajisjeve, makinerisë, linjat e prodhimit, softuerë, si dhe të ngjashme apo/dhe përmirësimin e proceseve dhe metodave prodhuese si dhe duke përfshirë asetet që mund t'i ndihmojnë kompanive të jenë më pak të varura nga faktorët e jashtëm;
- Trajnimi i specializuar në lidhje me investimet e lartpërmendura, p.sh. trajnime për përdorimin e pajisjeve apo teknologjisë së re (kjo komponent nuk mund të kalojë më shumë se 5% të vlerës totale të projektit);
- Aktivitete marketingu (p.sh. pjesëmarrja në panairë, si dhe/ose zhvillimi i uebfaqeve, etj.) për të promovuar produkte e shërbime më të mira apo të reja (kjo komponent nuk mund të kalojë më shumë se 5% të vlerës totale të projektit).

Llojet vijuese të veprimit NUK kualifikohen:

- Veprimet që kanë të bëjnë vetëm me apo kryesisht me sponsorizimet individuale për pjesëmarrje në punëtori, seminare, konferenca;
- Veprimet që kanë të bëjnë vetëm me apo kryesisht me bursat individuale për studime apo kurse trajnimi;
- Programet për kredi;
- Detyrat dhe veprimet operative që nuk lidhen me implementimin e projektit;
- Aktet që shkelin rregullat dhe rregulloret e njohura ndërkombëtarisht të cilat mbrojnë të drejtat e punëtorëve në Kosovë.

Projekti duhet të jetë në përputhje me objektivat dhe prioritetet e ThpP (Thirrjes për Propozime) dhe të garantojë dukshmërinë e financimit nga MZHR.

Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikant

Një aplikant nuk mund të dorëzojë më shumë se një aplikacion në këtë Thirrje për Propozime.

2.7 Kualifikueshmëria e shpenzimeve: kostot që mund të merren parasysht për grantin;

Të gjitha shpenzimet duhet të jenë në përputhje me rregullat e përcaktuara me këtë thirrje. Vetëm «kostot e kualifikuara» mund të merren parasysht për grant. Kostot e kualifikueshme duhen bazuar në shpenzime reale dhe dokumentet mbështetëse.

Kostot e kualifikueshme janë:

- Kostot që kanë të bëjnë me implementimin e aktiviteteve të kualifikuara;
- Janë shënuar në buxhetin e përgjithshëm të projektit;
- Janë të domosdoshme për implementimin e projektit;
- Janë të identifikueshme dhe të verifikueshme, në veçanti të regjistruara në regjistrat e kontabilitetit të Përfituesit(ve);
- Janë të arsyeshme, të arsyetuara brenda kërkesave të menaxhimit të qëndrueshëm financiar, sidomos në lidhje me ekonomizimin dhe efikasitetin.

Kostot e pakualifikueshme:

Kostot vijuese nuk kualifikohen:

- Borxhet dhe tarifat e mbulimit të borxhit;
- Provizionet për humbje dhe detyrime potenciale të ardhme;
- Interesat e borxhit;
- Tatimet në të hyra;
- Shpenzimet e deklaruara nga përfituesi dhe të mbuluara nga ndonjë veprim apo program tjetër pune;
- Blerja e tokës, ndërtimi apo riparimi i stabilimenteve/strukturave (përfshirë stabilimentet e depozitimit apo stabilimente/struktura të ngjashme);
- Humbjet në këmbim të valutës;
- Kreditë ndaj palëve të treta;
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- Shpenzimet e amortizimit, që normalisht duhet të jenë pjesë e mënyrës në të cilën ndahen fitimet;
- Tarifat bankare, shpenzimet e garancive dhe tarifa të ngjashme;
- Kostot e artikujve apo pajisjeve të përdorura;
- Pagat dhe medijt;
- Shpenzimet e lëndës së parë;
- Shpenzimet tjera operationale (qiraja, rryma, uji etj.)
- Automjetet e transportit;
- Shpenzimet e transportit;
- Inventari (Tavolinat, karriqet dhe dollapet, përjashtimit ato që ndërlidhen në mënyrë specifike me veprimtarinë)

Nëse kostot e pakualifikueshme arrijnë shumën mbi 20% të vlerës së projektit aplikacioni refuzohet. Shpenzimet e papranueshme janë çështje e përfituesit, prandaj ato nuk duhet të përfshihen në kërkesën për pagesë, kështu që përfituesi duhet të ketë mjete financiare vetanake për mbulimin e tyre.

Çdo tentim për mashtrim (psh. falsifikimi i faturave, manipulimi i procedurave të prokurimit, blerja e makinave apo pajisjeve të përdorura, etj.) do të ndëshkohet me mospagesë të asaj pjese që është subjekt i mashtrimit dhe ndëshkime shtesë deri në përjashtim total nga pagesa, siç parashihet me sistemin ndëshkimor që është pjesë e kontratës.

Është në interesin e aplikantit të paraqesë buxhet realist dhe efektiv për koston, gjithsesi Komisioni vlersues i MZHR-së ka kompetenca të trajtoj dhe hulumtoj tregun e çmimeve lidhur me çmimet e paraqitura në Ofertë dhe Buxhet në rastet kurë e vleron se çmimet nuk janë realiste.

Komisioni vlersues në rast se gjenë se çmimet e ofruara në ofertë e buxhet nuk janë realiste mund ti korrigjoj ato sikur që mundet aplikacionin ta diskualifikoj për mungesë korrektësie.

2.8 PROCEDURAT E PROKURIMIT

Procedurat e Prokurimit do të jenë pjesë e kontratës së nënshkruar në mes Autoritetit Kontraktues (MZHR) dhe përfituesit.

3. SI TË APLIKOHET DHE PROCEDURAT QË DUHEN NDJEKUR

3.1 Mënyra e aplikimit

Aplikantët ftohen të plotësojnë formularin e aplikimit duke përdorur formularin e aplikimit online të dizajnuar nga autoriteti kontraktues në platformën [ekosova](#); Aplikantët duhet t'i përmbahen strikt formateve të aplikimit dhe të plotësojnë paragrafët dhe faqet me rend.

Pako e Aplikimit, në bazë të natyrës së biznesit të Aplikantit:

i) Pako aplikimi për LOT 1 (start-up) si dhe dokumentet që duhet të plotësohen / ngarkohen në platformën [eKosova](#)

Formulari i aplikimit (plotësohet vetëm online përmes platformës [ekosova](#);

Shtojca 1: Deklarata e aplikantit që merret edhe si deklaratë nën betim për vërtetësinë e dokumentacionit e njejtë pasi të plotësohet nga aplikanti konvertohet në PDF dhe ngarkohet në folderin e dedikuar për të në platformën [eKosova](#).

Aplikantët të cilët mund të jenë përfitues potencial të grantit të kategorisë Lot 1 Start-up gjatë aplikimit duhet të kenë dokumentat në vijim dhe të njejtat ti ngarkojnë në follderat përkatës të platformës [eKosova](#):

Dokumentet tjera shtesë:

- Oferta për makinerinë apo pajisjet / shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit (*oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofruesit të ofertës dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës sikur që nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së thirrjes për propozime*);
- Ofertat në valuta tjera duhet të bashkangjesin kursin me të cilin është kalkuluar.

Vërejtje: Dokumentet e listuara me lart duhet te jenë me dukshmëri të qartë të formatit PDF dhe si të tilla të ngarkohet në folderin përkatës.

ii) **Pako aplikimi për LOT 1 biznes ekzistues, dokumentet që duhet të plotësohen / ngarkohen në platformen [eKosova](#)**

Formulari i aplikimit (plotësohet vetëm online përmes platformës [ekosova](#);

Shtojca 1: Deklarata e aplikantit që merret edhe si deklarat nën betim për vërtetësin e dokumentacionit e njehta pasi të plotësohet nga aplikanti konvertohet në PDF dhe ngarkohet në folderin e dedikuar për te në platformen [eKosova](#).

Aplikantët të cilët mund të jenë përfitues potencial të grandit nga kjo kategori gjatë aplikimit duhet të kenë dokumentat në vijim dhe të njejtat ti ngarkojn në follderat përkatës të platformës [eKosova](#):

Dokumentet tjera shtesë:

- Oferta për makinerinë apo pajisjet / shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit (*oferta duhet të përmbaj të dhëna të sakta të ofruesit të ofertës dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës sikur që nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së thirrjes për propozime*);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha fletët / informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, certifikata duhet të jetë e re lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues;
- Vërtetimi tatimor me validitet në ditën e aplikimit; me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK (mund të nxjerret online nga uebfaqja e ATK-së);
- Lista e punëtorëve për vitin e fundit fiskal (2021), të lëshuar nga ATK (mund të nxjerret online nga uebfaqja e ATK-së).
- Të ardhurat bruto të dëshmohen nga Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2021;
- Foto të objektit ekzistues të biznesit si dhe makinerinë / aparaturën e tanishme.

Vërejtje: Dokumentet e listuara me lart duhet te jenë me dukshmëri të qartë të formatit PDF kurse për foto mund të jenë në JPG dhe si të tilla të ngarkohet në folderin përkatës.

iii) **Pako aplikimi për LOT 2 biznes ekzistues, dokumentet që duhet të plotësohen / ngarkohen në platformen [eKosova](#)**

Formulari i aplikimit (plotësohet vetëm online përmes platformës [ekosova](#);

Shtojca 1: Deklarata e aplikantit që merret edhe si deklarat nën betim për vërtetësin e dokumentacionit e njehta pasi të plotësohet nga aplikanti konvertohet në PDF dhe ngarkohet në folderin e dedikuar për te në platformen [eKosova](#).

Aplikantët të cilët mund të jenë përfitues potencial të grandit nga kjo kategori gjatë aplikimit duhet të kenë dokumentat në vijim dhe të njejtat ti ngarkojn në follderat përkatës të platformës [eKosova](#):

Dokumentet tjera shtesë:

- Oferta për makinerinë apo pajisjet / shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit (*oferta duhet të përmbaj të dhëna të sakta të ofruesit të ofertës dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës sikur që nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së thirrjes për propozime*);

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha fletët/informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, certifikata duhet të jetë e re lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues;
- Vërtetimi tatimor me validitet në ditën e aplikimit; me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK (mund të nxjerret online nga uebfaqja e ATK-së);
- Lista e punëtorëve për vitin e fundit fiskal (2021), të lëshuar nga ATK (mund të nxjerret online nga uebfaqja e ATK-së).
- Të ardhurat bruto të dëshmuhen nga Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2021;
- Foto të objektit ekzistues të biznesit si dhe makinerinë / aparaturën e tanishme.

Vërejtje: Dokumentet e listuara me lart duhet të jenë me dukshmëri të qartë të formatit PDF kurse për foto mund të jenë në JPG dhe si të tilla të ngarkohet në folderin përkatës.

Aplikacionet mund të plotësohen në gjuhën Shqipe apo Serbe në platformën [ekosova](#) online.

Aplikacionet fizike apo të shkruara me dorë nuk do të pranohen.

Vetëm formularët e **PLOTËSUAR** të aplikimit dhe shtojca 1 do të kalojnë për vlerësim. Kështu, është me rëndësi kyçe që këto dokumente të përmbajnë **TË GJITHA** informatat relevante në lidhje me veprimin.

Vlerësimi i Aplikacioneve do të përfshijë një «kontroll administrativ» për të siguruar që aplikantët kanë përmbushur rregullat e kualifikimit (p.sh. aplikantët janë shtetas të Kosovës (për bizneset ekzistuese), si dhe biznesi është i regjistruar në Kosovë për Lotet 1 dhe 2. Procesi i vlerësimit teknik do të konsiderojë nëse Aplikacioni demonstroi që ndërmarrja ka perspektivë të mirë të të qenit e suksesshme dhe e qëndrueshme, si dhe që implementimi do të kontribuojë drejt përmbushjes së synimeve të Skemës së Granteve për të ndihmuar zhvillimin ekonomik të Kosovës. Grantet do t'i jepen aplikantëve me më shumë poena sipas rënditjes në secilin Lot, deri në kufijtë e buxhetit në dispozicion.

Në rastet kur ka mos përputhje të vlerave buxhetore në projekt, konfuzitet në përshkrim të projektit dhe gabim në përdorimin e formateve të përcaktuara në thirrjen për propozime, projekti do të diskualifikohet.

MZHR nuk është përgjegjëse për koston që ndërlidhet me përgaditjen e aplikacionit.

Përfituesit (pronarët e bizneseve që kanë përfituar grant) nga skemat Programi për Zhvillim Rajonal të Blancuar (PZHRB) 2020, Programi për Rimëkëmbje ekonomike (PRE MASA 8) 2020, Programi për Zhvillim Rajonal të Blancuar (PZHRB) 2021 dhe Programi për Rimëkëmbje ekonomike (PRE MASA 15) 2021 nuk kanë të drejtë aplikimi për këtë thirrje, sikur edhe ata që kanë dështuar në implementimin e projekteve nga këto skema.

3.2 Ku dhe si të bëhet aplikimi

Aplikimi bëhet online përmes platformës [ekosova](#); shih udhëzuesin e ASHI për mënyrë e aplikimit përmes [ekosova](#);

- Për Lot 1 (startup) Aplikimi duhet të bëhet nga personat të cilët synojnë të fillojnë biznesin e jo nga persona tjerë në emër të tyre;

- Për Lot 1 dhe Lot 2, (biznese ekzistuese) Aplikimi duhet të bëhet nga pronarët/Aksionarët e bizneseve siç figurojnë në ARBK <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,1>, apo të autorizuarit e tyre me autorizim të Noterizuar.

Në rast se vërehet se të dhënat e llogarisë në [ekosova](#), nuk përputhen me të dhënat në aplikacion MZHR do të diskualifikojnë atë aplikacion nga procesi i mëtutjeshëm.

3.3 Afati i fundit për aplikim

Afati i fundit për aplikim është **13 Prill 2022**, në ora **16:00** në platformën [ekosova](#); pas këtij afati mbyllet sistemi, aplikacionet fizike apo me postë nuk pranohen.

3.4 Informata të mëtutjeshme për aplikimin

Gjatë periudhës që fillon lansimi i thirrjes dhe publikimi i këtyre udhëzuesve ngjarjet publike dhe seancat informuese lidhur me lansimin e këtyre fondeve për procedurën dhe kriteret e caktuara për aplikantët e interesuar i organizon Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR).

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) do të organizoj sesione informuese në të gjitha Rajonaet Zhvillimore sikur që do të caktoj zyrtar përgjegjës për dhënjen e informacioneve/këshillave për palët e interesuara (brenda Objektivit Qeveritar / ish objekti i Rilindjes/ kati i tretë (III)

Megjithatë, mund të dërgohen pyetje shpesh në emailin vijues: blinda.bytyci@rks-gov.net më së voni deri më **25 Mars 2022 deri në ora 16:00**.

Me rastin e parashtrimit të pyetjeve ato duhet të jenë të qarta e të detajuara si dhe duhet specifikuar/treguar qartë referencën për Thirrjen për Propozime si dhe Lot-i specifik të cilit i referohet.

MZHR nuk ka për obligim të ofrojë qartësime të mëtutjeshme ndaj pyetjeve që dorëzohen pas **25 Mars 2022**

4. Kriteret e Vlerësimit

Për t'u para-selektuar, projekt propozimi duhet të arrijë së paku 50 pikë. Pas vlerësimit, aplikantët do të renditen sipas pikeve të tyre. Aplikimet me piket më të larta do të zgjedhen përkohësisht deri në shpenzimin e buxhetit në dispozicion.

| Pjesa / Elementet e notimit | Vlera e përgjithshme/Piket maksimale | |
|---|--------------------------------------|-----------|
| | START-up | LOT 1 & 2 |
| 1. Kapaciteti financiar dhe operacional | 20 | 30 |
| 2. Relevanca e veprimit | 25 | 20 |
| 3. Efektshmëria dhe arritshmëria | 25 | 15 |
| 4. Qëndrueshmëria e veprimit | 15 | 20 |
| 5. Buxheti dhe efektshmëria në kosto | 15 | 15 |
| GJITHSEJ PIKE (MAKSIMUM) | 100 | 100 |

5. ANKESAT

Pas publikimit të rezultateve aplikantët mund të adresojnë ankesat e tyre përmes rubrikes së veçantë në platformën [ekosova](#)

SHTOJCA 1: Deklarata e Aplikantit

Unë _____ përmes kësaj shtojce delararohem se aplikoj në Thirrjen e MZHR-Së (Ministrisë së Zhvillimit Rajonal) në kategorinë:

Lot _____,

Me këtë dokument, deklaroj që informatat e dhëna në këtë aplikacion janë të vërteta dhe të sakta,

Në rast se vërtetohet se informatat e dhëna në këtë deklaratë dhe në aplikacionin e platformës [eKosova](#) janë të pasakta apo të rreme pajtohem që autoritetet e MZHR të më diskualifikojnë në çfardo fazë, sikur që deklarohej se mbaj përgjegjësi për të gjitha pasojat.

Jam i vetëdijshëm se plotësimi dhe nënshkrimi i kësaj Shtojce është edhe një Deklaratë nën Betim, sikur që e kuptoj se plotësimi i Aplikacionit me dokumentacionin e kërkuar nuk garanton dhënien e grantit që kërkoj nga MZHR sipas kësaj Skeme të Granteve – PZHRB 2022.

Kontakti me të dhënat personale:

Emri i plotë: _____

(emri) (mbiemri)

Nr. i tel. _____

Emaili. _____

Pozita: _____

(Pronar, Aksionar, i Autorizuar)

Data: _____

Nënshkrimi: _____

Vula për Bizneset Ekzistuese:

Orari indikativ i PZHRB 2022

| Aktiviteti | Data | Ora | Vendi |
|---|------------|-------------|--|
| 1. Hapja për aplikim | 14.03.2022 | 08:00-16:00 | Sistemi eKosova (online) |
| 2. Afati i fundit për parashtrimin e pyetjeve | 25.03.2022 | 16:00 | MZHR blinda.bytyci@rks-gov.net |
| 3. Data e fundit që Autoriteti Kontraktues i jep sqarimet në pyetjet e parashtruara | 30.03.2022 | 16:00 | MZHR Ueb'faqe |
| 4. Afati i fundit për aplikim | 13.04.2022 | 16:00 | Sistemi eKosova (online) |
| 5. Informimi i aplikantit kryesor për hapjen dhe kontrollin administrativ (Hapi 1) dhe vlerësimin e Aplikacionit (Hapi 2) | 16.05.2022 | 08:00-16:00 | MZHR Ueb'faqe |
| 6. Afati i ankesave fillon prej publikimit të rezultateve preliminare. Sistemi eKosova (online) | 17.05.2022 | 08:00 | MZHR |
| 7. Mbyllja e afatit të ankesave. | 30.05.2022 | 16:00 | MZHR |
| 8. Kthim i përgjigjeve veç e veç palëve lidhur me ankesat. Sistemi eKosova (online) | 06.06.2022 | 08:00-16:00 | MZHR |
| 9. Nënshkrimi i kontratave | 08.06.2022 | 08:00-16:00 | MZHR |